

SEKSIONI XVI

MAKINERITË DHE PAJISJET MEKANIKE; PAJISJE ELEKTRIKE; Pjesët e tyre; REGJISTRUESIT DHE RIPRODHUESIT E TINGULLIT, REGJISTRUESIT DHE RIPRODHUESIT E IMAZHIT TELEVIZIV DHE TË ZËRIT, Pjesët dhe Plotësuesit e KËTYRE ARTIKUJVE

Shënime

1. Ky Seksion nuk përfshin:

- (a) rripat e transmisionit apo të konvejerëve apo rripat lidhës, prej plastike të Kapitullit 39, apo prej gome të vullkanizuar (kreu 4010); apo artikujt e tjerë të një lloji të përdorura në makineritë apo pajisjet mekanike apo elektrike apo për përdorime të tjera teknike, prej gome të vullkanizuar ndryshe prej gome të fortë (kreu 4016);
- (b) artikujt prej lëkure apo prej lëkure të përbërë (kreu 4205) apo prej gëzofi (kreu 4303), të një lloji të përdorura në makineritë apo pajisjet mekanike apo për përdorime të tjera teknike;
- (c) bobinat, rrotkat, kapëset, konet, bërthamat, cilindrat apo mbajtësit e ngjashëm, prej çfarëdo lloj materiali (p.sh., Kapitulli 39, 40, 44 apo 48 apo Seksioni XV);
- (d) Kardat e përforcuara për makinat jackuard apo makinat e ngjashme me të (p.sh., Kapitulli 39 apo 48 apo Seksioni XV);
- (e) Rripat e transmisionit ose të konvejerëve prej materiali tekstili (kreu 5910) apo artikujt e tjerë prej materiali tekstili për përdorimet teknike (kreu 5911);
- (f) Gurët e çmuar ose gjysmë të çmuar (natyrale, sintetike apo të rindërtuar) të krerëve 7102 deri në 7104, apo artikujt plotësisht prej gurëve të tillë të kreut 7116, përveç safirëve dhe diamanteve të punuar e të pa montuar për stoli (kreu 8522);
- (g) Pjesët e përdorimit të përgjithshëm, siç përcaktohet në Shënimin 2 të Seksionit XV, prej metali bazë (Seksioni XV), apo mallrat e ngjashëm prej plastike (Kapitulli 39);
- (h) Gypat shpues (kreu 7304);
- (ij) Ripa të pafund prej teli apo shiritash metali (Seksioni XV);
- (k) Artikujt e Kapitullit 82 apo 83;
- (l) Artikujt e Seksionit XVII;
- (m) Artikujt e Kapitullit 90;

- (n) Orët e të gjitha llojeve apo artikujt e tjerë të Kapitullit 91;
- (o) Veglat e ndërrueshme të kreut 8207 apo furçat e një lloji të përdorura si pjesë e makinave (kreu 9603); veglat e ndërrueshme të ngjashme do të klasifikohen në përputhje me materialet përbërës të pjesës së tyre të punës (psh, në Kapitullin 40, 42, 43, 45, apo 59 apo në kreun 6804 apo 6909);
- (p) Artikujt e Kapitullit 95; apo
- (q) Shirita për makina shkrimi apo shirita të ngjashëm, nëse janë apo jo të paraqitura në bobina apo në karriçe (të klasifikuar sipas materialit të tyre përbërës, apo në kreun 9612 nëse janë të bojatisur apo të përgatitur për të lënë gjurmë), apo monopodet, bipodet, tripodet dhe artikujt e ngjashëm, të kreut 9620.
2. Nënshtruar ndaj Shënimit 1 të këtij Seksioni, Shënimit 1 të Kapitullit 84 dhe Shënimit 1 të Kapitullit 85, **pjesët e makinave** (që nuk janë pjesë të artikujve të krerëve 8484, 8544, 8545, 8546, apo 8547) do të klasifikohen në përputhje me rregullat e mëposhtëm:
- (a) Pjesët të cilat janë mallra të përfshira në ndonjë prej krerëve të Kapitujve 84 apo 85 (të ndryshme nga krerët 8409, 8431, 8448, 8466, 8473, 8487, 8503, 8522, 8529, 8538 dhe 8548) do të klasifikohen në të gjitha rastet në krerët e tyre respektive;
- (b) Pjesët e tjera, nëse janë të përshtatshme për t'u përdorur vetëm apo kryesisht me një lloj të veçantë makine, apo me një numër makinash të njëjtit kre (përfshi një makinë të kreut 8479 apo 8543) do të klasifikohen me makinat e atij lloji apo në kreun 8409, 8431, 8448, 8466, 8473, 8503, 8522, 8529 apo 8538 siç mund të jetë e përshtatshme. Megjithatë, pjesët të cilat janë të përshtatshme në mënyrë të barabartë për t'u përdorur kryesisht me mallrat e krerëve 8517 dhe 8525 deri në 8528 do të klasifikohen në kreun 8517; dhe pjesët të cilat janë të përshtatshme për përdorim vetëm ose kryesisht me mallrat e kreut 8524 do të klasifikohen në kreun 8529;
- (c) Të gjitha pjesët e tjera do të klasifikohen në kreun 8409, 8431, 8448, 8466, 8473, 8503, 8522, 8529 apo 8538 siç mund të jetë e përshtatshme apo, nëse jo, në kreun 8487 apo 8548.
3. Derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, **makinat e përbëra** që konsistojnë në dy ose më shumë makina të përshtatura së bashku në formë të një tërësie dhe makinat e tjera të përshtatura për qëllime të kryerjes së dy ose më shumë funksioneve plotësues apo alternativ do të klasifikohen sikur përbëhen vetëm nga ai komponent ose sikur është ajo makinë e cila kryen funksionin kryesor.
4. Kur një makinë (përfshirë një kombinim makinash) përbëhet prej komponentëve individuale (qoftë të ndara apo të ndërlidhura nëpërmjet linjzimeve, me anë të mjeteve të transmisionit, me anë të kabllove elektrike apo me anë të mjeteve të tjera) të destinuar të kontribuojnë së bashku për një funksion të përcaktuar qartë të përfshirë në një nga krerët e Kapitullit 84 apo Kapitullin 85, atëherë e gjitha bie të klasifikohet në kreun e përshtatshëm me atë funksion.
5. Për qëllimet e këtyre Shënimeve, shprehja "**makinë**" kupton çdo makinë, makineri, impiant, pajisje, aparat apo mekanizëm të përshkruara në krerët e Kapitullit 84 apo 85.
6. (A) Gjatë gjithë nomenklaturës, shprehja "mbeturina dhe mbeturina elektrike dhe elektronike" nënkupton montimet elektrike dhe elektronike, bordet e qarkut të shtypur dhe artikujt elektrikë ose elektronikë që:
- (a) janë bërë të papërdorshëm për qëllimet e tyre origjinale nga prishja, prerja ose procese të tjera ose janë ekonomikisht të papërshtatshëm për riparim, rinovim ose rinovim për t'i bërë ato të përshtatshme për qëllimet e tyre origjinale; dhe
- (b) janë të paketuara ose të transportuara në një mënyrë që nuk ka për qëllim të mbrojtë artikujt individualë nga dëmtimi gjatë transportit, ngarkimit dhe operacionet e shkarkimit.
- (B) Ngarkesat e përziera të "mbeturinave dhe skrapit elektrik dhe elektronik" dhe mbeturinave dhe mbeturinave të tjera do të klasifikohen në kreun 8549

(C) Ky seksion nuk mbulon mbetjet komunale, siç përcaktohet në shënimin 4 të Kapitullit 38 ..

Shënime shtesë

1. Pjesët e nevojshme për montimin, apo mirëmbajtjen e makinerive klasifikohen në këto makineri kur importohen së bashku. Pjesët e ndërrimit të importuara me makineritë gjithashtu klasifikohen tek makineritë nëse ato përbejnë pjesë normale të makinerisë dhe shiten bashkë me to.
2. Nëse dogana e kërkon, deklaruesi duhet të paraqesë, në mbështetje të deklaratës së tij, një dokument të ilustruar (p.sh. instruksione, prospekte, faqe katalogu, fotografi, etj.) që tregojnë përshkrimin normal të makinerisë, përdorimin dhe karakteristikat thelbësore të saj dhe, për sa i përket makinerive të cilat janë të pa montuara ose të çmontuara, plan montimin dhe listën me përmbajtjen e kolive (pakove) të ndryshme.
3. Me kërkesën e deklaruesit dhe kur plotësohen kushtet e dhëna nga autoritetet kompetente, për makineritë e importuara në ngarkesa të ndara, zbatohen dispozitat e rregullit të përgjithshëm 2(a).